



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 995/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Levizja Vetevendosje (LVV) paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK) për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor ne raundin e dyte te zgjedhjeve lokale , në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Levizjes Vetevendosje (LVV) dega ne Prishtine .

Arsyetim

PZAP-i, më datë 02.12.2013 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Levizja Vetevendosje (LVV), në të cilën theksohet se me datën 01.Dhjetor 2013, ne ora 12:00 veshguesi i LVV-se Nol Nushi ka njoftuar subjektin e vet politik LVV-ne se aktivisti i Lidhjes Demokratike te Kosoves (LDK) Naser Ramadani, ka hyre dhe ka dale tri here rradhazi ne qendren e Votimit 1927E, pas informates se marre nga veshuesi yne me urgjence informuam prokuroren kujdestare znj.Ikramie Bojaxhiu dhe Policine e Kosoves me qellim te intervenimit per largimin e personit ne fjale nga kjo qender e Votimit.

Vepimi i aktivistit te LDK-se, Naser Ramadani perbën shkelje te rregulles Zgjedhore 11/2013 Neni 7 par.1 pika .b ku ndalohet berja e fushates meqe i njeiti ka bere presion tek votuesit me pranine e tij duke cenuar vullnetin dhe fshehtesine e votuesve. Ne baze te ketyre pretendimeve te shprehura ne ankese dhe ne baze te deklaratave te deshmitareve , kerkojme nga PZAP-i qe sipas bazes ligjore te shprehur ne nenin 32.2 te ligjit per Zgjedhjet e Pergjithshme, te shqiptohet sanksioni adekuat ndaj subjektit politik dhe ndaj shkelesit Naser Ramadani.

Kesaj ankese do ti bashklidhen deklaratat e Nol Nushit dhe komisioneres Bejnaze Gashi te LVV-se

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmita e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se eshte penguar procesi Zgjedhor , PZAP-i i vlerëson si pabazuar dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LKP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 995/2013 më datën 04.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*